# DËSHMI ARKIVI

**A-462597**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Trump ultimatum Iranit në OKB: Marrëveshje pas zgjedhjeve, ose do t'ju shkatërroj. Presion edhe Putinit: Ndalo luftën |
| ADRESA | `https://a2news.com/rajoni-bota/bota/trump-ultimatum-iranit-ne-okb-marreveshje-pas-zgjedhjeve-ose-do-i1185661` |
| BURIMI | a2news.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 18:49:38 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 23 shtator 2026, 05:28:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `1a677afe9ff8162dea11938fe1ea72cefd0053dfe566ab36196b790db999be43` |
| TEKSTI | `1345fae0f5d404258fc6e6294dab25dd40cfd061456294b215f39bdcd786ddba` |
| PAMJA | `64a457de834b1563e7f91cbaff42ba3bf3db3cc31cf9a2289f6e2ccf3c24428a` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `3436d0d0ca753d3a0f1f55ee9d58b2f246ec850ce84f4ccdd0d8792dcab8bac5` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/3436d0d0ca753d3a0f1f55ee9d58b2f246ec850ce84f4ccdd0d8792dcab8bac5`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Trump ultimatum Iranit në OKB: Marrëveshje pas zgjedhjeve, ose do t'ju shkatërroj. Presion edhe Putinit: Ndalo luftën

Nga A2 CNN
23 Shtator 2026, 07:28 | Bota



Presidenti i SHBA-së, Donald Trump, përdori fjalimin e tij në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së për të paralajmëruar udhëheqësit botërorë. Nga Rusia në Iran dhe Kubë, presidenti amerikan  sulmoi të gjithë kundërshtarët përveç Amerikës, për të cilën tha se tashmë është më e fortë se kurrë" dhe se "epoka e artë" është tani një realitet.

Në lidhje me luftën Rusi-Ukrainë, Trump tha se SHBA po punon me liderët e të dy vendeve dhe se synon një përfundim të konfliktit përmes një marrëveshjeje, ndërsa i bën thirrje Vladimir Putinit që t'i japë fund luftës në Ukrainë

*"Putin, mbaron luftën!"*, ishte mesazhi i tij drejtuar kreut të Kremlinit, përpara fjalimit të tij dhe takimit të planifikuar dypalësh me presidentin ukrainas Volodymyr Zelensky.

Por pjesa më e fortë e fjalimit, për të cilën Trump ngriti tonet ishte ultimatumi që i dha Iranit.

*"Duhet të vendos nëse do ta shkatërroj Iranin apo do të bëj një marrëveshje. Dhe nëse më duhet t'i shkatërroj, do ta bëj shpejt. Por jam i bindur se do ta bëjnë marrëveshjen pas zgjedhjeve"*, tha ai me zë të lartë, duke treguar edhe një herë tonet kërcënuese mbi diplomacinë.

Ai kërkoi gjithashtu që vendet e tjera të mbështesin izolimin ekonomik të Iranit derisa Teherani të ndalojë sulmet ndaj anijeve tregtare, të heqë dorë nga ambiciet bërthamore dhe të ndërpresë mbështetjen për grupet që SHBA i konsideron terroriste.

Përgjigja nga udhëheqja ushtarake e Teheranit ishte e menjëhershme: Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura Iraniane dhe Shtabi Qendror Khatam al-Anbiya, njësia më e lartë komanduese operative e Republikës Islamike, paralajmëruan se vendi do të shkaktonte goditje "edhe më të rënda, shkatërruese dhe të paparashikueshme" ndaj sulmuesve.

Trump sulmoi edhe Kubën, duke e cilësuar regjimin komunist si një "një shtet i dështuar që do të rrëzohet". Gjatë këtyre deklaratave, delegacioni kuban u largua nga salla e Asamblesë së Përgjithshme.

*"Kartelet e drogës janë si ISIS, dhe Meksika është epiqendra e dhunës së karteleve. Është e papranueshme që Shtetet e Bashkuara të ndajnë mijëra kilometra kufi me territorin e*

TE FUNDIT

"Skandale të tjera" paralajmëron Gjoni: Së shpejti do dalin përgjimet ku kanë shkuar lekët e inceneratorëve

"Pse drejtoreshë ndërmarrje është ajo?!", Petraj: Rrallë ndodh në botë të jepen masa sigurie për shefat e Inteligjencës

Në kërkim për trafik ndërkombëtar kokaine, arrestohet në Rusi Shpëtim Aliu

NATO ngre bombarduesit, helikopteri shkel kufirin polak, qëndron 42 sekonda

MË TË VIZITUARAT

Ndryshon ligji për pensionet private, me më shumë garanci! Mbrojtje nga falim...

Zelensky: Jemi gati për armëpushim në Detin e Zi, presim përgjigjen e Rusisë...

"Po mbrohet Vlora Hyseni", Berisha: SPAK nuk e cilëson anëtare të grupit të ...

LIVE UPDATES

Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë

LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore

Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

*kontrolluar nga kartelet armike*", theksoi ai, duke kërcënuar të përdorë "fuqinë ushtarake amerikane për të mbrojtur interesat e SHBA-së në kontinent.

Më pas, Trump sulmoi ashpër Gjykatën Ndërkombëtare Penale, duke i kërkuar të gjithëve të distancohen prej saj.

Fjalimi 37-minutësh i presidenti Trump përfshiu gjithashtu çështje si inteligjenca artificiale, Venezuela, siguria ndërkombëtare dhe roli i SHBA-së në botë.

**(A2 Televizion)**


**A2 CNN Livestream**

MUND TE LEXONI GJITHASHTU

SHBA ndërton dy baza të reja ushtarake në Groenlandë, zbulohen detaje nga marrëveshja e Trump

Vendi i NATO-s i jep dritën jeshile armëve bërthamore, Rusia paralajmëron pasoja

Rusia mbulohet nga dronët, fillon "sezoni i dytë" i ofensivës ukrainase

Kërcënimi i Trump nga "Pallati i Qelqtë", "Irani të bëjë marrëveshje ose do t'i çoj në ferr"

"Avioni më vdekjeprurës", teknologjia e F-35 bie në duart e kinezëve

Beteja për Detin e Kuq, Houthitë marrin bregdetin, Irani me një armë të re mbi botën

boten

## Latest Videos




"Lidhja e Vlorës dhe Gysit po përdoret për të përfituar lehtësira"Ish-prokurori: Ja çfarë fshihet




Çfarë po fshihet? Përgjigjet e Agasit dhe Hysenit, Kikia ngre alarmin: Ka shumë më shumë se...




Prania besnike edhe në PD?"Gazetari sjell detaje: Berisha ka kërkuar gjithë drejtuesit e qarqeve të...




"Skandali në SHISH", Berisha mbledh partinë, gazetari zbulon planin e demokratëve: Ja porosia për...



© 2023 A2 CNN / G2 Media shpk
All Rights Reserved.

Mundësuar nga Mediadesk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.